

Universiteti i Prishtinës bashkëpunon me WUS-Austria

## 2 programe të reja për studime master

Universiteti Publik ka nënshkruar kontratë për fillimin e dy programeve të reja për studime master në fakultetet e UP-së. Kjo është bërë në bashkëpunim me WUS-Austria, zyra në Prishtinë

**Drita Vitia**

PRISHTINË, 29 MAJ

Universiteti i Prishtinës, në bashkëpunim me WUS-Austria, zyra në Prishtinë, kanë nënshkruar kontratën për fillimin e dy programeve të reja të studimeve master në fakultetet e Universitetit të Prishtinës. Për drejtimet e reja master në Menaxhim të Shëndetësisë, Fakulteti i Mjekësisë dhe Master në Mekatronikë, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, do të pranohen studentë që nga tetori i këtij viti nga njëzet e pesë studentë. Programi për Zhvillim të Studimeve Master (MSDP), përkrah fakultetet e interesuara të Universitetit të Prishtinës në zhvillimin e programeve master në bazë të nevojave të tregut të punës dhe kuadrot e të cilave janë më se të nevojshme për këtë treg në Kosovë. Ky program jep mundësinë e zhvillimit të kurrikulës së re në bashkëpunim me Institucionet e arsimit të lartë të Austrisë si

dhe në bashkëpunim me institucione, organizata dhe biznese vendore. Prandaj, theks i veçantë i vihet përkrahjes strategjike në zhvillimin e programeve master të cilat përqendrohen në kërkesat e tregut të punës të cilat rezultojnë në zbatimin praktik të dijenisë, bashkëpunimit me Institucionet e Arsimit të lartë të Austrisë dhe efekti i Kthimit të trurit apo Brain Gain. Qëllimi kryesor i këtij programi është të lehtësojë tranzicionin e institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë në drejtim të përmbushjes së standardeve Evropiane përmes procesit të Bolonjës. WUS Austria me përkrahje financiare nga Austrian Development Cooperation do të përkrahë zhvillimin dhe modifikimin e lëndëve të reja, krijimin e mundësive për konsultim me partnerët Austriak përmes vizitave studimore, bashkë-ligjërime me kolegët austriakë, aktivitete trajnime për profesorë, blerje të literaturës në fushat përkatëse, zhvillimi i skripteve, si dhe blerje të pajisjeve.